

FATMIR AGALLIU

EMRAT QË PËRDOREN VETËM NË SHUMËS NË GJUHËN SHQIPE

Për emrat që përdoren vetëm ose kryesisht në numrin shumë, të cilët në literaturën gjuhësore quhen me termin pluralia tantum, tek ne nuk është bërë ndonjë studim i veçantë. Numri relativisht i madh i emrave që s'kanë njëjës dhe karakteri produktiv i disa grupeve të tyre na shtynë që t'i bëjmë objekt trajtimi në këtë artikull. Këtë studim ne do ta bëjmë nga pozita thjesht përshkruese, duke u nisur nga përdorimi i gjallë i fjalëve në gjuhë.

Sqarimi i natyrës së këtyre emrave lidhet ngushtë me problemin e kategorisë gramatikore të numrit tek emrat. Veçoritë e gjuhës shqipe në këtë pikë deri më sot janë ndriçuar në mënyrë të pamjaftueshme. Edhe në gjuhën shqipe kategoria e numrit tek emrat është polifunksionale. Një emër në numrin shumë veç kuptimit të shumësisë së thjeshtë, mund të ketë edhe kuptime të tjera. Ndryshimet e theksuara në kuptim midis njëjësit të disa kategorive të emrave dhe shumësit të tyre janë fakte, që janë vënë re edhe nga disa gramatikanë të gjuhës shqipe¹.

Tek shumësat e emrave *mirësitë, ligësitë, marrëzitë, pabesitë, mbarësitë*, të përdorura nga Naim Frashëri, N. Jokli shihet shumësa të intensitetit².

Këtu mendojmë se duhet shënuar si diçka që të bie në sy fakti se formanti *-urina* trajtohet nga K. Cipo si formant numri (shumës i farës)³, megjithëse quhet, ndryshe nga formantet e tjera të numrit, jo mbaresë, por prapashtesë, ndërsa për të njëjtin formant A. Xhuvani dhe E. Çabej shprehen kështu: «Me këtë prapashtesë janë formuar në toskërishten një tok emrash shumë kolektivë prej emrash në njëjës a në shumë nganjëherë me rrugë analogjie: degurina (degë), farurina (farë), halurina (halë), kashturina, (kashtë), lakrurina (lakra), pemurina (pemë), qelqurina (qelq), rroburina (rroba), shkarpurina (shkarpa), shpesurina (shpes). Kjo prapashtesë tregon, siç shihet nga shembëllat, një shumicë farësh të ndryshme të një sendi, të një lënde a të një frymori: qelqurina, lloje a enë të ndryshme prej qelqi, shpesurina, shpes të ndryshme»⁴.

Me të drejtë autorët e studimit të përmendur «Prapashtesat e gjuhës shqipe» shohin në formimet me prapashtesën *-urina* fjalë të ndryshme, emra që përdoren vetëm në numrin shumë dhe kanë kuptim kolektiv.

Një ndryshim kuptimi i madh vihet re edhe në atë që zakonisht quhet shumë i llojeve, tek emrat lëndorë (si masë kompakte e pandashme në njësi) me prapashtesën *-ra: vajëra, ujëra, djathëra, kripëra, mishra* etj., megjithatë ne nuk mund të shkojmë aq larg sa t'i marrim këto si fjalë të

1) K. Cipo, *Sintaksa*, Tiranë, 1952, f. 17.

2) Cituar sipas E. Çabej, *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1967, f. 19.

3) K. Cipo, *Gramatika shqipe*, 1949, f. 56.

4) A. Xhuvani — E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, f. 104.

ndryshme, sepse lidhja kuptimore midis njëjësit të po atyre fjalëve dhe shumësit të tyre mbetet ende e fortë.

Shtirirja e gjerë e shumësit në gjuhën shqipe nga një anë dhe nevoja për të shprehur kuptime të tjera nga ana tjetër, i japin mundësi folësit të formojë shumësin edhe prej fjalësh që nga natyra e tyre s'kanë numër shumë.

Në përfundim të një evolucioni që zë fill në një periudhë të vjetër të gjuhës shqipe, shumësi i emrave në këtë gjuhë u dallua prehtazi nga njëjësi i të njëjtëve emra. Me kohë për numrin shumësi u formua një temë e ndryshme, e cila shërben si bazë për paradigmen e lakimit në këtë numër⁵ dhe shpeshherë edhe për formimin e fjalëve të reja. Ky faktor, së bashku edhe me faktorë të tjerë, mendojmë se e kanë bërë të lehtë përdorimin e trajtës së shumësit edhe për njëjësin, d.m.th. singularizimin e shumësit. Kërkimet etimologjike kanë treguar se numri i këtyre rasteve është mjaft i madh⁶.

Për kuptimin e natyrës së shumësit të emrave në përgjithësi dhe të atyre që zakonisht përdoren vetëm në njëjës në veçanti, ka rëndësi të përcaktohet mirë koncepti i numrit në gramatikën e sotme, të përcaktohet mirë në ç'gjë qëndron opozicioni midis njëjësit dhe shumësit. Fakti se në gjuhë ekzistojnë grupe emrash që përdoren vetëm në një numër, në njëjës ose në shumësi, provon se kategoria e numrit nuk është kategori thjesht gramatikore, se ajo lidhet edhe me kuptimin leksikor të emrit. Ajo u shkon për shtat sidomos emrave, që tregojnë sende që mund të numërohen. Këta emra ne kemi mundësi t'i përcaktojmë me lehtësi me anë të një numërori themelor. Në këtë rast njëjësi dhe shumësi i këtyre emrave janë forma gramatikore të ndryshme, që s'kanë asnjë dallim përsa i përket kuptimit leksikor të temës. Në këtë klasë emrash shumësia paraqitet si diçka e diferencuar (lis-a, viç-a, fshat-ra, djalë-djem), e ndashme në njësi.

Në këtë opozicion që u paraqit këtu, midis njëjësit dhe shumësit në emrat që tregojnë sende të numërueshëm, përmbledhet përmbajtja themelore e kategorisë së numrit në gramatikë. Por shumësin e gjejmë edhe në emra të kategorive të tjera semantike. Kështu, mund të përdoren në shumësi edhe disa emra që shënojnë masa lëndësh, për të cilët u fol më sipër, disa emra abstraktë dhe pak emra kolektivë, nga ata që idenë e kolektivitetit e shprehin kryesisht në numrin njëjës. Neve na duket se në gjuhën shqipe kategoria e numrit shumësi ka marrë një shtirirje të gjerë në grupe të ndryshme leksikore të emrit. Kështu shpjegohet edhe fakti se emrat abstraktë në shqipen nuk e kanë të vështirë të përdoren edhe në numrin shumësi (turp-turpe, ndere⁷, vuajtjet, gëzime-t etj.). Në këtë rast ata përfaqësojnë shfaqje konkrete të tiparit ose të veprimtimit abstrakt, që shprehin.

Në gjuhësi janë dalluar përgjithësisht tek shumësi i emrave dy kuptime themelore: *kuptimi diferencues sasiore* dhe *kuptimi kolektiv*⁸. Për shembull, emri *lakër* tregon një barishte me fletë të mëdha e të mbështjella me njëra-tjetrën; shumësi i fjalës me të njëjtin kuptim shërben për të diferencuar sasinë: një lakër — dy (a më shumë) lakra. Me kuptimin tjetër të tij: barishte të buta e të egra, shumësi i fjalës ka kuptim kolektiv.

5) W. Cimohowski, *Le dialecte de Dushmani*, f. 43, A.V. Desnickaja, *Mbi strukturën morfologjike të gjuhës shqipe* (përkthim), «Buletin i USHT», 3, 1959, f. 223.

6) E. Çabej, *vepër e cituar*.

7) Fjalori i K. Kristoforidhit, sipas botimit të 1961-së, f. 225.

8) V.V. Vinogradov, *Russkij jazyk*, M., 1947, f. 156.

tiv. *Leqe* është forma e shumësit e emrit lak, një vegël për të zënë zogj ose egërsira, por leqet (e këmbës) përdoret edhe si kolektiv për të shënuar pjesë të gjymtyrëve të trupit të njeriut. Kështu edhe përpjekje (ndeshje midis dy forcave) dhe *përpjekje-t* (orvatje, të bërët çmos), tire (shumës i fjalës që tregon penj pambuku, që përdoren për të thurur perde). Në shumës kjo fjalë shënon edhe çarapet e leshta, të bardha e të gjata për gra. Këtu kemi të bëjmë me fenomenin e njohur të «leksikalizimit» të formës së numrit shumës, i cili ka shpënë shpeshherë në formimin e homonimeve, për shembull, forma e shumësit e emrit kryq — kryqet është larguar shumë nga kuptimi prej fjalës, shumës i së cilës ka qenë, dhe është shndërruar në një fjalë më vete, në një emër që përdoret vetëm në numrin shumës (pluralia tantum). Ky fenomen pasqyrohet edhe nëpër fjalorë. Në gjuhën shqipe ka edhe raste kur kuptimet e ndryshme të një fjale janë diferencuar edhe me format e ndryshme të numrit shumës, duke marrë fjalë me kuptimin e ri një trajtë tjetër të shumësit, për shembull emri *rreth* me kuptimin e parë në numrin shumës përdoret me trajtën *r Rathë*, kurse në kuptimin e dytë (ndarje administrative e territorit) përdoret në këtë numër me trajtën *rrethe*.

Qëllimi ynë në këtë artikull nuk është paraqitja e plotë e kuptimeve të shumësit të emrave në gjuhën shqipe. Kjo do të përbënte objektin e një trajtimi më të gjerë, detyrë të cilën ne nuk ia kemi vënë vetes.

Në gjuhësi është i përhapur mendimi, sipas të cilit emrat që përdoren vetëm në shumës, shpeshherë kanë kuptim përmbledhës, se ata tregojnë jo një shumicë të thjeshtë si sasi, por një shumësi tërësore, një shumësi në unitetin e vet. Autori i këtij artikulli pajtohet me këtë mendim dhe shpreson ta vërtetojë edhe me material nga gjuha shqipe. Por midis emrave kolektivë që përdoren vetëm ose kryesisht në njëjës dhe emrave pluralia tantum ka një dallim. Emrat e tipit të dytë e vënë në dukje idenë e shumësisë më mirë se atë të bashkësisë⁹.

Duke folur për shtimin e numrit të emrave pluralia tantum me fjalë të reja. V.V. Vinogradovi shkruan: «Nuancat e ndryshme të kuptimit përmbledhës janë një mbështetje e gjallë për formimin e emrave të rinj pluralia tantum»¹⁰. Si u tha, në gjuhën shqipe ky grup emrash paraqitet pak a shumë i gjerë, disa nëngrupe dallohen për produktivitet, në ndonjë nëngrup kanë ndikuar edhe gjuhët e tjera.

Studimet etimologjike tregojnë se në gjuhën shqipe ka edhe raste lindjeje të emrave të tillë edhe nëpërmjet rrugës së kthimit në shumës të emrit përmbledhës me formë njëjësi. Kuptimi i parë i fjalës *dhentë* (delet) duhet të jetë tufë¹¹. Më vonë fjala e ngushtoi kuptimin dhe sot përdoret si shumës kolektiv për emrin dele-t; me kuptim kolektiv ajo shënon edhe deshtë e shqerrat së bashku me delet. Duke kthyer në shumës një fjalë që përdoret edhe si emër abstrakt edhe si kolektiv, po duke u nisur nga kuptimi abstrakt i saj, në Gjirokastrë fjalën *pleqësitë* në shumës e përdorin me kuptimin e punëve të pajtimist midis dy palëve kundërshtare. Një të tillë formim ne shohim edhe në përdorimin e sotëm në shumës me kuptimin konkret (vend) të emrit abstrakt *afërsitë*, për shembull: Kjo ndodhi në *afërsitë* e qytetit.

9) E.A. Référovskaja — A.K. Vasiliéva, *Essai de grammaire française*, Cours théorique, f. 43.

10) V.V. Vinogradov, *po aty*, f. 164.

11) E. Çabej, *Studime rreth etimologjisë së gjuhës shqipe*, «Studime filologjike», 2, 1965, f. 18.

Tekstet gramatikore të gjuhës shqipe, që kanë qenë kryesisht libra mësimore, emrat që përdoren vetëm në shumës, vetëm sa i kanë përmendur, pa bërë asnjë klasifikim të tyre. Nga kjo paraqitje është krijuar edhe përshtypja se shqipja ka pak emra të tillë. Faktet gjuhësore tregojnë të kundërtën. Gjuha shqipe në këtë pikë del mjaft e pasur.

Në literaturën gramatikore të huaj është i njohur klasifikimi i këtyre emrave në grupe sipas semantikës së tyre. Studimet në plan krahasues tregojnë se midis gjuhëve motra indoevropiane në këtë fushë të gramatikës ka mjaft gjëra të përbashkëta¹². Në veprën e tij «Gjuha ruse» V.V. Vinogradovi dallon për rasishten dymbëdhjetë grupe emrash të kësaj kategorie. Me përjashtim të ndonjë grupi, ata i njejnë edhe gjuha shqipe. Në shqipen hasen në shumës edhe emrat e disa sëmundjeve, siç e ka vënë re së pari E. Çabej¹³. Klasifikimin e emrave pluralia tantum të gjuhës shqipe ne do ta bëjmë duke u nisur nga kuptimi i tyre i përgjithshëm, pra baza e klasifikimit do të jetë semantike. Brenda grupeve kemi dalluar nëngrupe, sipas kuptimit të fjalëve, duke bërë vërejtje edhe për veçoritë fjalëformuese, pa cënuar bazën semantike të klasifikimit. Për disa grupe kemi vënë në dukje edhe ndonjë karakteristikë të përgjithshme bashkuese, që kemi mundur të vëmë re.

Parase të kalojmë në shqyrtimin e grupeve, po shënojmë këtu se në këtë klasë, veç emrave që s'njohin tjetër formë numri, përveç asaj të shumësit, ne kemi përfshirë edhe ata emra, që në njëjës përdoren më rrallë se në shumës, ose njëjësi i të cilëve është sekondar në krahasim me shumësin.

Duke u mbështetur në materialin e mbledhur, i cili nuk pretendon të jetë shterues, ne kemi mundur të dallojmë këto grupe emrash:

1) *Emra që tregojnë sende të përbërë*. Ky grup fjalësh është mjaft i pasur. Brenda këtij grupi dallojmë më tej këto nëngrupe:

a) *Emrat që tregojnë sende çift ose sende të përbërë nga dy pjesë të njëjta*. Nëngrupi është i mbyllur, jo produktiv. Kuptimi çift shfaqet në emra të tillë: *Brekët*, me të gjitha sinonimet dialektore. Në fjalorin e Kristoforidhit me këtë kuptim gjenden si shumësa fjalët *të lintat* dhe të *paanat* (Shkodër, Tiranë), kurse në atë të Gazullit gjendet fjala *lule-t* me këtë kuptim dhe me atë të benevrekëvevet. Fjalët *të lintat*, *të paanat*, *të mbathurat*, *mbathjet*, që përdoren gjithandej si sinonime të fjalës *brekë-t*, janë derivate, tri të parat të formuara me anë të substantivimit të femërores shumë të mbiemrit, kurse fjala e fundit është një formim me prapashtesën *-je* nga folja *mbath*, një nga ato të paka formime me këtë prapashtesë, që tregojnë petka, sende etj. d.m.th. jo fjalë abstrakte¹⁴.

Substantivimi është një rrugë mjaft produktive për formimin e emrave pluralia tantum në gjuhën shqipe.

Fjalë që tregojnë sende të përbërë nga dy pjesë janë edhe: *gërshërët*, që përdoret kryesisht në shumës. Fjala takohet edhe në njëjës, sidomos kur ka kuptim figurativ: të gjithë janë prerë me një gërshërë, gërshëra e parë (qethja e parë e dhenve), *darët* (përdoret rrallë edhe në njëjës), *syzat*, *tumanet* së bashku me sinonimin *çitjanet*, *shallvaret*¹⁵ së bashku

12) O. A. Gumilevskaia i L.S. Karum, *Kategoria çislla imjon syshçestvitelnyh v anglijskom i njemeckom jazukah v sopostavlennii s russkim*, në librin «V pomoshç prepodavateljam inostranyh jazykov», Novosibirsk, 1964.

13) E. Çabej, *vepër e cituar*, f. 26.

14) A. Xhuvani — E. Çabej, *vepër e cituar*, f. 62.

15) Njëjësi i fjalës *shallvare* gjendet në toponimin «Fusha e shallvares».

me sinonimin e tij *pantallonat*, që është fjalë e huazuar, *benevrekët*, *kof-sharet*, *sheshjet* (pantofla), *brekushet*.

Kryesisht në shumës përdoret edhe fjala *hejbe-të*, që tregon një lloj traste me dy pjesë; është huazim nga turqishtja. Me kuptimin e fjalës *hejbe* Kristoforidhi shënon në fjalorin e tij për Gjakovën fjalën *kuqe-t*. Po kur synohet njëra pjesë e sendit të përbërë, në gjuhën popullore fjalën *hejbe* e gjejmë të përdorur edhe në njëjës: «I mbushën një *hejbe* me flori dhe një *hejbe* me peksimet së shkretës¹⁶. Në letërsinë artistike fjalën *hejbe* e gjejmë zakonisht në shumës: «— Dhe ti, qahaja-bash, mos iu nda Zotit hetues. Pas m'i rri, me kamxhikët dhe *hejbetë gati*»¹⁷. Në këtë nëngrup duhet futur edhe fjala *prangat*, që përdoret në shumës, edhe në gjuhë të tjera: *kandally* (në rusishten), *fetters* (në anglisht) dhe *Fesseln* (në gjermanisht). Kjo fjalë në shqipen ka sinonime fjalët (*hekura-t*, *vargonj-të*, *zinahira-t*).

Disa gjuhëtarë formimet e sotme të shumësit të emrave që tregojnë sende çift në gjuhët sllave, ku dokumentohet duali, i konsiderojnë si gjurma të tij¹⁸. Në gjuhën shqipe duali që ekzistonte në gjuhën indo-evropiane dhe shënonte dy objekte, është zhdukur krejtësisht pa lënë asnjë gjurmë¹⁹, prandaj në këtë gjuhë as që mund të flasim për një lidhje të tillë. Kjo është edhe arsyeja që ne këta emra nuk i ndamë në një grup më vete, po i përfshimë brenda grupit, që tregon sende të përbërë prej disa pjesësh.

b) *Emrat që tregojnë pjesë të trupit: vithe-t* (vetëm si shumës) përdoret edhe në frymorët edhe në njerëzit, *cullufet* (rrallë haset edhe si njëjës), *kryqet* (edhe në trajtën kryqëzat), *leqet* me sinonimin e tij dialektor *gliqet*, *mustaqet*, për të cilin Kristoforidhi shënon si të papërdorshëm njëjësin. Në të vërtetë ndihet ca më pak se shumësi edhe forma e njëjësit: në gegërishten *mustaku* dhe në toskërishten *mustaqja*. Këtu duhet futur edhe shumësat përmbledhës, që tregojnë një shumicë sendesh të njëlllojtë nga pjesët e trupit të frymorëve: *dokrat* (shumës me *-ra* nga fjala *dokë*, një lloj koçani, që mori kuptimin e kockave të mëdha të trupit), *gicat* (kicat) — dhëmbët e fëmijëve, *kocomillat* (Gazulli, 207), *plimërat* (të brendshmet e berrit) etj.

c) *Gjëra të përbëra prej disa pjesësh, vegla të tilla: këmbjet, skitë, rrathët* (shumës i sotëm i fjalës rreth, dikur trajtë e njëjësit, që më vonë u bë shumës) — vegël peshkimi, *tespihet, tirqitë* etj.

2) *Emra që tregojnë sende të ndryshme*, të cilat marrin një emërtim të përbashkët në bazë të funksionit të tyre ose të ndonjë karakteristike të tyre të përbashkët.

Fjalët e parme janë të pakta: *orenditë, crulet* e ndonjë tjetër, shumica janë fjalë të prejardhura, të formuara me prapashtesën — *urina* — *plackurina, rroburina, degurina, pemurina, halurina* etj. Emrat e prejardhur sipas këtij tipi kanë kuptimin: *plaçka të ndryshme, rroba të ndryshme* etj.

Me këta afron nga kuptimi edhe emri *vjetërsirat* (kolektiv për gjerat e vjetra, sende, veshje etj.).

3) *Emrat që tregojnë njerëz dhe frymorë të tjerë*. Në këtë grup po fusim disa emra frymorësh, që nën një emërtim të përbashkët, shënojnë

16) *Proza popullore*, vëll. II, 1966, f. 335.

17) J. Xoxa, *Lumi i vdekur*, vëllimi II, f. 68.

18) V. V. Vinogradov, *po aty*, f. 160.

19) M. Domi, *Morfologjia historike e shqipes*, dispensë, Tiranë, 1961, f. 6.

një shumicë qenjesh si diçka të pandarë, në formën e një të tërë të padingencuar. Këto janë fjalë me një kuptim kolektiv të vërtetë, që shfaqin një nocion kolektiv tipik.

Këtë e provon edhe fakti se, me ndonjë përjashtim, këto fjalë nuk pranojnë dot një numëror themelor. Ndërsa thuhet një dele, dy dele, katër dele, dy dhen, katër dhen nuk mund të themi. Kur themi dy kokë dhen, numërori themelor i takon emrit kokë.

Ndër emrat e këtij grupi që tregojnë njerëz, njohim fjalët: *vetë* (veta), që nuk përdoret fare në njëjës: përbëhemi nga pesë vetë, mungojnë dy vetë etj. Në terminologjinë gramatikore kjo fjalë përdoret edhe në njëjës, veta e parë, veta e dytë etj. Në fjalorin e Gazullit (f. 98) gjindet edhe fjala *çaravadet*, si fjalë krahinore për të treguar njerëz, gjindje. Ka të ngjarë që sufiksi *-z* në fjalën njerëz dikur të ketë pasur kuptim kolektiv. Ndër emrat që shënojnë frymorë, njihen si fjalë që përdoren vetëm në shumës këto: dhentë (përdoret edhe si shumës supletiv për delet sidomos në toskërishten dhe në gjuhën letrare sot), *shqerrat*, *shtërriakët* me kuptim më të ngushtë, *shtërriat*. Nga të tria fjalët e fundit, të cilat kanë kuptim të afërt, e njohur në gjithë gjuhën është fjala *shqerrat*, të cilën me formën fonetike *shkjerrat* e gjejmë, sipas Gazullit, edhe në Veri.

Në të folmet e Shqipërisë veriore përdoren për të treguar gjarpërinjtë fjalët *gjylpajt* e *drapajt*, që nuk njohin njëjës. Me këtë grup fjalësh po afrojmë edhe disa të tjera, që tregojnë figura, qënje mitologjike, të cilat janë parafytyruar nga besimi popullor në trajtë njerëzore. Të tilla janë fjalët sinonime për *zanat* të marra grumbull: *kore-t*, *të lumet* (me eufemizëm), *samovilat*, *të jashtëmet shtojzovallet* (besohet se është përngjitje nga shprehja «Shtoji, Zot, vallet!») Fjalët e të tri grupeve që u analizuan deri këtu, d.m.th. emrat që tregojnë sende të përbëra nga dy ose më shumë pjesë, emrat që tregojnë sende të ndryshme të marra së bashku dhe emrat që tregojnë njerëz ose frymorë, bashkohen nga një karakteristikë e përbashkët, sepse kanë që të gjitha, kush më shumë e kush më pak, kuptim kolektiv.

4) *Emrat që tregojnë masa të një lënde, sende të mburjtura prej një lënde.*

Emrat që tregojnë lëndë si një masë të panumërueshme në gjuhën shqipe përdoren vetëm në njëjës. Ndër fjalët e përdorshme vetëm në shumës me këtë kuptim haset fjala *hime-t* me sinonimet e shumta të saj: *krundet* (në Elbasan, sipas Kristoforidhit, thuhet edhe *krunde-a* në njëjës), *shetet* dhe derivati i saj *këshetet*, *gërdhushtat*. Përdorimi i kësaj fjale vetëm në shumës do lidhur me kuptimin e saj të veçantë. Himet janë mbeturinat e miellit, pasi ai shohet a sitet. Emrat që tregojnë të mbeturat e një procesi (shih më poshtë), zakonisht përdoren vetëm në shumës. Këtu duhen futur edhe fjalët *qurret* dhe *djersët*. Në këtë grup emrash ne po fusim edhe ato formime të tjera me prapashtesën *-urina*, të cilat tregojnë sende të bërë prej një lënde si *qelqurina* (enë të ndryshme prej qelqi dhe jo *qelqe* të ndryshme), formimet me sufikset e shumësit *-e* dhe *-ra* që kanë marrë plotësisht kuptim fjalëformues: *ergjënde* (stolitë e ergjënda) dhe *bakërre* (edhe bakërre, për enët prej bakërri). Me këtë grup mund të afrojmë edhe kolektivin *flokët*, njëjësi i të cilit sa vjen e po bëhet pak i përdorshëm në kuptimin e qimes (shih togfjalëshin qime floku).

Këtu po shtie edhe një shumicë emrash, që tregojnë kryesisht bimë të ndryshme, të vështruara në gjithë llojet e tyre, të cilat përmblihen në një nocion të vetëm kolektiv. Në bazë të këtij nocioni më shpesh vihet

një tipar i përbashkët, që shprehet nga një mbiemër, i cili substantivohet në trajtën e numrit shumës.

Në radhën e këtyre fjalëve po përmendim: *të korrat, të vjelat, të lashtat, të mbjellat* (përdoret edhe si abstrakt për të treguar kohën e të mbjellit), *të vonat, farishtet, barishtet, erëzat, puligaret*²⁰, *manaferrat, njomësinat, bardhat* (sipas Gazullit, në Lumë përdoret për të lashtat, për bimët e mbjella herët, për grurin, elbin, tërshërën etj.).

Fjala e fundit duket që është një substantivim i formës së gjinisë femërore të mbiemrit të përdorur dikur pa nyje.²¹ Siç duket edhe nga shembujt, numri i emrave që përdoren vetëm në shumës në këtë grup fjalësh është relativisht i madh dhe disa tipa janë të gjallë e produktivë, si formimet me sufiksin *-isht(e)* dhe trajtat e substantivuara të mbiemrave.

5) *Emra që tregojnë një shumë a grumbull të hollash.*

Në këtë grup fjalësh hyjnë pak emra, shumicën e të cilëve e njuh gjuha letrare, sidomos në stilin zyrtar të saj. Mjaft prej tyre janë formuar për nevojat e zhvillimit të vendit dhe nën ndikimin e gjuhëve të huaja. Po përmendim:

Të hollat si sinonim i fjalës *para-të*, e cila përdoret në të dy numrat, *të ardhurat, të dalat, të prishurat, të prapambeturat.*

Me këto funksione janë veshur edhe kuptimet figurative të fjalëve *burim, mjet* — *burimet financiare, mjetet financiare.* Fjala *financat* përdoret në shumës me atë kuptim edhe në gjuhët e tjera — në frengjisht *financés*, në gjermanisht *Finanzen* dhe në anglisht *finances.*

Siç shihet, shqipja ka përdorur shpesh substantivimin e mbiemrit për të shprehur konceptet financiare, që edhe gjuhët e tjera i shprehin me emra në trajtën e numrit shumës.

6) *Emra që tregojnë mbeturina.*

Në këtë grup do të fusim ato fjalë që tregojnë gjëra të hedhura ose përgjithësisht mbeturina të një lënde si përfundim i një procesi. Këtu duhen përmendur në radhë të parë emrat që vijnë nga substantivimi i mbiemrit foljor të gjinisë femërore në trajtën e shumës. Tema foljore shënon procesin e veprimit, të cilit i janë nënshtruar sendet që mbajnë tiparin kolektiv të shënuar nga mbiemri: *të lënat, të fshirat, të shplarar, të mbeturat, sitkat* (nga folja *sit, sita, situ*, me sufiksin *-kë*), *shkrepat* (e miellit), *përlasinat, resnikët* (shih fjalorin e Gazullit), *bëzhdilet, reshjet* etj. Ky grup fjalësh është pak produktiv.

7) *Emrat abstraktë*

Këta emra tregojnë veprime ose procese komplekse, që përgjithësisht formohen nga shumë akte ose lëvizje, ose prej aktesh dhe veprimesh të përsëritura.

Fjalët me kuptime të tilla dhe në përgjithësi abstraktët që përdoren vetëm në shumës në gjuhën shqipe, janë të shumtë. Ky është një nga grupet me produktivë të emrave pluralia tantum në gjuhën shqipe.

Brenda këtij grupi mund të dallojmë këto nëngrupe:

a) Emrat që tregojnë veprime ose gjendje abstrakte. Ndër ta kemi mjaft substantivime të mbiemrit foljor në trajtën e gjinisë femërore

²⁰ Gazulli e shpjegon me gjermanishten *Unkraut*. Në rusishten i thonë *sornaja trava, bar i keq, d.m.th.* në shqip del si përmbledhës për barërat e këqia.

²¹ Për këta mbiemra shih E. Çabej, *Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe*, «Buletin i USHT», 3, 1963, f. 82-83.

shumës²², për shembull: të prerat, të dhemburat, të ngjethurat, të përqethurat, të hyrat (veprime financiare), emra të tjerë si nazet, lajkat, filmet, rumuzet, dushkat, fitet, shurdhat, ledhet, katikulet, tekat, kallat (të dy emrat e fundit janë formime jo afiksale të një tipi të veçantë prej foljevet më teket dhe kall me prapashtesën e shumësit -a, e cila vishet këtu me një funksion fjalëformues), shumësa të emrave foljorë sufiksale të formuar me prapashtesën -im: hetimet, kërkimet, gjurmimet, hulumtimet. Me këtë grup shkojnë edhe emrat abstraktë rrethanat, peripetitë, reprezaljet.

b) Emra me kuptime të ndryshme abstrakte.

Në radhë të parë këtu po përmendim shumësat e mbiemrave të substantivuar: të mirat, të këqijat (nga të këqijat që kam hequr), të ligat, të palarat, të paudhat, të cilët largohen kuptimisht prej mbiemrave të substantivuar e mira, e keqja, e liga ose prej mbiemrave të vërtetë i palarë, i paudhë, sepse shënojnë shfaqje të ndryshme të tiparit. Me të drejtë në «Fjalorin e gjuhës shqipe» emri të ligat është vënë si një fjalë e veçantë:

Mjafton ta krahasojmë me kuptimin që ka në shprehjen popullore «Të marrsha të ligat».

Emra të tjerë: vomet dhe sinonimi i tij ligjet, trocet, tujet, gjepurat, dëngëlat, të falat, hokat, munxët dhe sinonimi i saj paçet, të cilin E. Çabej e nxjerr nga dëshirorja i paç²³. Me kuptimin e këtyre dy fjalëve të fundit, si sinonim i tyre, përdoret edhe fjala namëzat, të cilën Kristoforidhi e shënon në shumës në shprehjen i dha namëzëtë. Duket që është një derivat nga emri namë (nëmë) — mallëkim dhe bën pjesë në ato formime me sufiksën -zë, që largohen në kuptim prej temës bazë.

Në disa gjuhë të tjera indoevropiane, sidomos në rusishten, ka disa emra që përdoren vetëm në shumës dhe tregojnë një periudhë kohe p.sh. sumerki, kanjikullij, sutki në rusishten, Ferien në gjermanishten. Nën ndikimin e gjuhëve të tjera edhe në shqipen shumësi i emrit pushim-pushime po përdoret me kuptimin e fjalëve vacances të frengjishtes, vacanze të italishtes dhe Ferien të gjermanishtes.

Ndikimin e gjuhëve të tjera në përdorimin e emrave në shumës e ka vënë re edhe K. Cipo, i cili shkruan për këtë: «Një pakicë emrash e përdorin shumësin edhe në vend të njëjësit. Njëi tillë përdorim mund të ketë hyrë ose nga ndikimi i gjuhëve të huaja, nga vetë fjala që mund të ketë edhe pluralitet ose për efekt të ndonjë analogjie. Kështu themi, p.sh. Pushimet e mëdha do t'i kaloj në Pogradec. Kështu themi lesht dhe leshtat»²⁴. Përveç shumësit të emrit pushimi, që përdoret me kuptimin e disa fjalëve që në gjuhë të tjera janë pluralia tantum dhe emrit plakat, që tregon një periudhë kohe nga mbarimi i marsit dhe fillimi i prillit, s'kemi mundur të gjejmë shembuj të tjerë. Këtij grupi mund t'i shtojmë edhe një numër të kufizuar fjalësh të tjera, që janë përdorur më parë për të treguar kryesisht festa fetare ose janë lidhur me përkujtimin e disa ditëve të shënuara sipas besimit popullor. Përdorimi i tyre në shumës do lidhur me faktin se kemi të bëjmë ose me festa a rite që zgjatnin disa ditë, ose me ngjarje që përbëhen nga disa veprime komplekse. Ndër emrat e të krem-

22) Ka edhe raste, kur trajta e shumësit me -a, e cila është e barabartë si për femërorët, ashtu edhe për asnjësit dhe na vë përpara pyetjes në kemi të bëjmë me shumësa femërorësh apo asnjësitish, përdoret në vend të njëjësit me atë kuptim: të marra e të dhëna (Kristoforidhi) për të marrë e të dhënë, si në shprehjen «ata kanë të marrë e të dhënë me njëri-tjetrin.»

23) E. Çabej, *vepër e cituar*, f. 20.

24) K. Cipo, *Sintaksa*, 1952, f. 17.

teve që gjenden kryesisht në formën e shumësit përmendim: *kërshëndellat*, *pashkët*, shajet (edhe rreshajet), poganitëqet, *kalendrat* a këllanat (Gazulli), *krëshmet*, *shestjet*²⁵, *rusicat* etj. Disa nga këto fjalë i gjejmë edhe në njëjës, por ky përdorim është më i rrallë. Kështu, p.sh. fjala *pashkët* në një këngë popullore takohet në formën e njëjësit «Ditën e pashkës së madhe Dhoqina na hidhej valle». Më shpesh kanë thënë *Pashkët e mëdha*. Fjala *poganitëqet* në formën e njëjësit *poganik* mund të jetë një formim regjogned prej shumësit²⁶.

Një vend të veçantë brenda këtij grupi zënë emrat, që tregojnë zakone të vendit, që lidhen me ditët e përkujtimit të të vdekurit. Nga forma këtu kemi të bëjmë me substantivime të mbiemrit «numëror» rrjeshtor në trajtën e shumësit të gjinisë femërore: *të tretat*, *të shtatat*, *të dyzetat*. Përdorimi i tyre në shumës, siç dihet, ka të bëjë me prirjen e përgjithshme që emrat e të kremteve të përdoren më fort në shumës. Në këtë rast nuk përjashtohet edhe mundësia e ndikimit të faktorëve të tjerë që lidhen me bestytnitë e popullit.

Së fundi, në këtë grup po fusim edhe disa fjalë të paka, që tregojnë mënyra mjekimesh, të përdorura nga populli sipas përvojës së tij dhe në përputhje me besimin që ka ekzistuar se sëmundjet shkaktohen nga forca të këqija, që mund të largohen me anë të yshturash.

Në fjalorin e gjuhës shqipe gjendet fjala *primet* me kuptimin «mjekime të mjekësisë popullore». Duket që kjo fjalë është një derivat foljor me *-im*, formuar nga folja pruej-ruaj nga një sëmundje. Me këtë kuptim është përdorur edhe fjala të *pruajtunat*, të cilën e ka Budi. Fjala *primet* ka një shtrirje të kufizuar në Shqipërinë e mesme. Me kuptimin e mjekteve të mjekimit popullor përdoret edhe shumësi i fjalës mjekim — *mjekime*; fjala *mjeqet* ka po atë kuptim. Këtu po shtiem edhe fjalën *të yshturarat*, shumë kolektiv, si duket prej asnjansit foljor *të yshtur*, që këtu ka marrë një kuptim më konkret dhe qëndron ndaj të yshtur, ashtu si *yshtjet* qëndron ndaj *yshtje*. Njëjësi i saj përdoret më rrallë: «Njeriu nuk shërohet me të yshtur».

3) Emra sëmundjesh.

Në gjuhën shqipe ka edhe një numër jo të vogël emrash, që tregojnë sëmundje dhe përdoren në shumës. Këtë fenomen që është i njohur edhe në gjuhë të tjera, disa e shpjegojnë me besimin primitiv të njerëzvet se sëmundjet gjoja shkaktohen prej demonesh²⁷. Ka të ngjarë që kjo të ketë lidhje më tepër me faktin se këto sëmundje kanë mjaft shenja me të cilat shfaqen, zgjatin për një farë kohe, ose përsëriten në të njëjtën formë. P.sh. ethet fillojnë zakonisht me të dridhura e me temperaturë dhe këto kanë parasysh kur thonë «po më zenë ethet».

Emri *ethet*, që është nga më të përdorshmit e këtij grupi, mund të gjendet edhe në trajtën e njëjësit, por kjo trajtë, siç duket nga përdorimi i saj i rrallë, është trajtë sekondare. Ndonjëherë e gjejmë edhe në literaturë: «Ai ndihej si në një *ethe* tronditëse, që e rrëmbente të gjithin... (Dalan Shaplllo, Zëri i Popullit, 3 maj, 1967).

Në gjuhën shqipe ka mjaft fjalë sinonime që përdoren në shumës dhe tregojnë rregullin mujor të gruas (fr. menstruation). Përdorimi i tyre në shumës, do lidhur në radhë të parë me përsëritjen periodike. P.sh. *adetet*,

25) E. Çabej, *vepër e cituar*, f. 142.

26) E. Çabej, *vepër e cituar*, f. 29.

27) E. Çabej, *vepër e cituar*, f. 26.

zakonet, nishanet përbëjnë homonime me shumësat e emrave adet, zakon, nishan. Fjalët *lulet, të bardhat* janë formuar, si duket, në bazë të eufemizmës, kurse në formimet të *larat, gjakrat*, vihen në bazë të emërtimit tipare të ndryshme. Gazulli shënon në fjalorin e vet me këtë kuptim fjalën *hanët*, që është një përdorim figurativ nga hënët e muajit.

Emra të tjerë sëmundjesh në shumës janë: *grykët, shytat, flamët*. Fjala e fundit më shpesh përdoret në njëjës dhe tregon një figurë të besimit popullor, shkaktare të epilepsisë. Duhet pasur parasysh se disa emra sëmundjesh në gjuhën shqipe hasen kryesisht në njëjës si *fruthi, lija, kolla e bardhë, kolla e mirë, qerja, zgjebja* etj.

9) Emra lojërash.

Vetëm në shumës përdoren edhe disa emra lojërash, të cilët, përgjithësisht, janë fjalë me kuptime të ndryshuara shumë, sa që mund të merren edhe si fjalë të ndryshme.

Për të emëruar lojëra përdoren shumësat e disa fjalëve si *kupat, filxhanet, pllakat*, ndonjë fjalë tjetër si *vervelicat*, emri foljor *fshehet*, formuar si fjala *tekat*, për të cilën u shprehën më sipër, kompozita popullore *mbyllasizat*, formuar nga togfjalëshi mbyll sytë.

Përdorimi i emrave të lojërave në shumës duhet shpjeguar, sipas mendimit tonë, me faktin se një lodër është një proces që zgjat një farë kohe, përbëhet prej disa veprimesh që përsëriten, prandaj shpjegimi, që u është dhënë emrave të grupit 7, ka vlerë edhe për këto fjalë.

Përsa u përket disa trajtave të rrjedhore shumë me *-sh*, që shënon E. Çabej në studimin e përmendur dhe të cilat përdoren për të treguar lojra, ne mund të bëjmë këtë vërejtje: sipas mendimit tonë këtu kemi të bëjmë vetëm me shprehje të ngurosurra, ku emri në rasën rrjedhore i përdorur pranë foljes luaj shënon mënyrën e të luajturit e më tutje edhe llojin e lodrës: me luejtë *kuprecash*, me luejtë *bojnash, breshkash, shkopijsh* etj.

10) Emra vendesh.

Në toponomastikën e vendit tonë ka një numër të madh emrash të përveçëm që shënojnë zakonisht ara, livadhe, kullota dhe pyje dhe përdoren vetëm në shumës²⁸. Emërtimi ka shkuar ose sipas një karakteristike të vendit si pemë të ndryshme, varre, veçorive të terrenit etj.: *Dardhat, Kumbullat, Lisat e Qishës, Lugjet, Shtyllat, Varret e Helmit, Mrizet* etj. ose nga emri i një personi a llagapi: *Osmënet, Hasamatet, Memogjinet* etj. Në anë të ndryshme të Shqipërisë takojmë shpesh toponime kolektive për arat: *Arat e Zenelit, Arat e Metos, Arat e Mitatit* (Kurvelesh), *Arat e Komonit, Arat e Keqe* (Lumë) etj. Ka toponime që lidhen me ndonjë tipar të vendit e që janë të përhapura gjithandej si emri *Çërrilat*²⁹ në Patos të Mallakastrës (ara e livadhe) dhe në Tepelenë (fshat), në formë njëjësi — Çërrilë,a.

Ka edhe emra krahinash, që përdoren në shumës si *Vakëfet, Rrëzat* (shumës i rrëzës së malit) në Shkodër *Rranzat*. Disa emra të përveçëm gjeografikë, që përdoren në shumës në gjuhë të tjera, edhe kur kanë hyrë në

28) Shembujt jepen duke u mbështetur kryesisht në materialet e mbledhura nga Rahmi Memushaj mbi toponomastikën e Kurveleshit.

29) Për kuptimin e fjalës shih fjalorin e gjuhës shqipe — curril, fill uji që del çurg. Për përhapjen e mëtejshme të saj shih E. Çabej, *vepër e cituar*, f. 96.

shqipen e kanë ruajtur këtë tipar. Të tillë janë fjalët *Alpet, Dardanelet, Karpatet, Andet, Apeninet* etj.

Emrat e maleve dhe të vargmaleve me burim shqip si rregull përdoren në njëjës. Emrat e vargmaleve që sot përdoren si emërtime individuale, si emra të përveçëm, në krye të herës duhet të kenë pasur një nuancë kolektiviteti.

Në gjuhën shqipe ka edhe një numër emrash të përgjithshëm që shënojnë përgjithësisht vend dhe janë fjalë të prejardhura në shumicën e tyre. Vendi karakterizohet nga tipar themelor që përmban kuptimi leksikor i temës, prej së cilës janë formuar këto fjalë. Midis gjithë këtyre fjalëve dallohet emri i parmë *viset*.

Brenda këtij grupi mund të ndajmë këto nëngrupe:

a) Fjalë të formuara nga emra të tjerë të përgjithshëm, që tregojnë një vend, kuptimi i të cilit ka dalë në bazë të raportit, sasior, ku shumësia vështrohet në unitet. Kemi të bëjmë me shumësia emrash të tjerë të përgjithshëm, që janë larguar tepër në kuptim prej njëjësit dhe janë shndërruar në fjalë të veçanta: *lugjet* (nga *lug*), *rrihnat* (nga *rrah-u* me ndërrim të zanores), *vithnat* (nga *vathë* po me atë rrugë). Me këtë tip shkon nga pikëpamja e strukturës edhe fjala *ndërlumnat* (ndërlymnat) — fjalë dialektore, ku emërimi ka shkuar në bazë të tiparit të pozicionit.

b) Pak fjalë si *rrethinat, afërsirat*³⁰, *grronat*. Nga kuptimi afron me to edhe fjala *kulteret* — të gërryerat që pëson guri a shkëmbi prej ujit.

Shumësat e llojërave të disa emrave lëndorë me prapashtesën *-ra* kanë kaluar me metonimi në emërin e vendit ku shitet në treg një prodhim i caktuar — *drithnat, oriznat, leshnat, djathnat, miellnat*. Këto fjalë janë të kufizuara në ndonjë të folme të gegërishtes.

* * *

Nga ky vështrim, që nuk pretendon të jetë i plotë, i atyre emrave që përdoren vetëm ose kryesisht në formën e numrit shumës, del se gjuha shqipe është e pasur me emra të këtij lloji.

Në këtë punim nuk janë lënë jashtë fjalët pak të përdorshme dhe ato me shtirje të kufizuar dialektore. Këtë ne e kemi bërë, së pari, për të dhënë një pasqyrë sa më të plotë të kategorisë së emrave në shqyrtim dhe, së dyti, për të vënë në dukje pasurinë e gjuhës. Jashtë vështrimit tonë nuk kanë mbetur edhe disa fjalë të huaja, që kanë hyrë edhe në gjuhën shqipe. Një pjesë e tyre i takojnë leksikut ndërkombëtar. Lënja e tyre jashtë këtij studimi do të na dukej pa vend. Në ndonjë rast është parë edhe ndikimi i gjuhëve të tjera në formimin e fjalëve të kësaj kategorie.

Në themel të klasifikimit, si u tha, qëndron kriteri semantik, por për çdo grup janë bërë edhe vëzhgime për strukturën fjalëformuese të fjalëve, për të nxjerrë në shesh rrugët dhe mjetet e pasurimit të leksikut me fjalë të kësaj kategorie.

Veç largimit të formës së shumës nga kuptimi prej fjalës bazë dhe shndërrimit të saj në një fjalë më vete, procesit të shtimit të numrit të emrave pluralia tantum në gjuhën shqipe i ndihmon mjaft edhe substantivimi i mbiemrit, sidomos i atij me prejardhje foljore.

30) Si u tha, sot po përdoret me këtë kuptim, sidomos në shtyp, emri *afërsitë*.

R é s u m é

LE PLURALIA TANTUM EN ALBANAIS

L'auteur fait un essai d'étude complète des noms qui ne sont usités qu'au seul pluriel en albanais. A la base du travail réside la classification de ces noms en groupes d'après leur sens le plus général. A la base de la division en groupe a été mis le critère sémantique. Mais, à leur intérieur, il faut distinguer des sousgroupes particuliers, d'après l'acception plus partielle. L'auteur a fait aussi des observations sur la structure de formation, à partir de mots, des noms de cette catégorie.

Au commencement l'auteur s'arrête sur certaines questions de la catégorie du nombre des noms, qu'il considère insuffisamment élucidée jusqu'à présent dans les grammaires de la langue albanaise. Cela est rendu nécessaire afin d'expliquer les groupes différents des noms usités uniquement ou principalement au pluriel ainsi que les voies de leur enrichissement. L'auteur soutient l'opinion connue que les noms qui ne sont usités qu'au seul pluriel ont souvent un sens collectif, ils désignent non point une simple pluralité dans le sens de la quantité, mais une pluralité totale, une pluralité dans son unité.

Dans les manuels de grammaire de l'albanais, les noms usités au seul pluriel sont mentionnés par quelques exemples, mais ils n'ont pas été classifiés. De cette ébauche on a l'impression que l'albanais a un petit nombre de tels noms. Les matériaux glanés et illustrés dans le présent travail indiquent que l'albanais est assez riche de pluralia tantum.

En dehors de l'abondance de groupes qu'on trouve également dans d'autres langues, en albanais sont usités au seul pluriel aussi les dénominations de quelques maladies, comme l'a fait remarquer, le premier, notre E. Çabej. Des matériaux glanés pour la toponymie de certaines zones de l'Albanie il résulte que sont usités au pluriel aussi plusieurs noms de lieux: prairies, champs, forêts et d'autres zones, considérés dans un sens collectif.

Dans cet exposé, en dehors des noms qui ne connaissent pas d'autre forme de nombre en dehors de celui pluriel, sont compris aussi ces noms qui au singulier ont un usage plus rare qu'au pluriel, ou bien dont le singulier est secondaire par rapport au pluriel.

Sur la base du matériel glané, l'auteur a distingué dix groupements de mots. Les mots inclus dans cet exposé sont considérés comme richesse lexicale de tout l'albanais. D'après les cas, on a fait ressortir aussi l'extension dialectale de quelque mot ainsi que ses synonymes dialectaux.

Au premier groupement sont classés les noms indiquant des objets composés comme: të mbathurat, syzat, gërshërët, darët, hejbetë, etc. Quelques uns de ces mots, comme les darët et hejbetë ont un usage plus rare aussi au singulier. Dans ce groupe rentrent aussi quelques mots qui indiquent des parties du corps, comme: vithet, kryqet, leqet, etc.

Au deuxième groupement rentrent les noms indiquant différents objets, qui prennent une dénomination commune sur la base de leur fonction ou bien de quelque caractéristique commune. A l'exception de quelques mots comme orenditë, crulet, dans la plupart des cas on est en présence de mots dérivés, formés à l'aide du suffixe -urina: plaçkurina, rroburina, degurina, halurina, etc.

Au troisième groupement sont insérés des noms d'animaux qui, sous

une dénomination commune, indiquent une quantité d'êtres, comme quelque chose d'invisible, sous la forme d'un tout non différencié. Il s'agit de mots d'un sens collectif véritable, qui extériorisent une notion collective typique. Tels sont: vetë (dy vetë), dhentë (aussi comme pluriel supplétif pour les moutons), shqerrat, les mots synonymes pour les fées, considérées en groupe: koret, të lumet, shtojzovallet, etc.

Au quatrième groupement rentrent les noms désignant la mesure d'une matière, des objets faits d'une matière: himet, avec les nombreux synonymes dialectaux: krundet, shetet, gerdhushtat, këshetat: ergjënde (argenterie), bakërre (les récipients en cuivre). La majorité de ces noms est formée par des adjectifs substantivés: të korrat, të vjelat, të lashtat, të mbjellat, të vonat, etc.

Au cinquième groupement vont les mots indiquant un amas d'argent: të hollat, të ardhurat, të prapambeturat, etc.

Au sixième, les mots désignant des résidus résultant de la fin d'un procès, des ordures. La plupart ce sont des noms dérivés, des substantivations de l'adjectif verbal du genre féminin sous la forme du pluriel: të lënat, të fshirat, të shplarar, të mbeturat. Ce groupement est peu productif.

Le septième groupement réunit des noms de sens naturel abstrait, désignant des actions ou bien des processus complexes, formés en général par plusieurs actes ou mouvements, ou bien par des actes et des actions répétés. Les mots de ce groupe sont nombreux: të prerat, të ngjeturat, nazet, lajkat, tekant, të ligat, të palarat, gjepurat, të falat, etc. Sous l'influence d'autres langues, a connu une extension au pluriel aussi le nom pushimet (vacances, loisirs, allem. Feiren, russe kanikuly). En dehors du nom pushimet, dans le sens de la météorologie ou du temps, en albanais on a seulement le nom plakat (= la période de temps allant vers la fin du mars et le commencement d'avril).

Dans ce groupement l'auteur a fait rentrer aussi les noms de quelques fêtes religieuses ou bien des jours de commémoration des morts, qui ont un usage au pluriel: pashkët, kërsëndellat, kreshmët, rusicat, të tretat, të shtatat, të dyzetat: quelques noms de traitement empirique comme: primet, mjeqet, të yshturat.

Au huitième groupement vont les noms de ces maladies qui ont une période de temps de rechute ou de prolongation: ethet (très rarement au singulier), zakonet, avec leurs nombreux synonymes.

Au neuvième groupement rentrent les noms désignant des jouets et au dixième les noms de lieu.

L'auteur a mentionné dans son travail aussi ces emprunts étrangers qui ont acquis droit de cité en albanais et qui, en général, appartiennent au lexique international. Une place considérable occupent dans son exposé les notes sur la formation des mots des différents groupements, cela dans l'intention de mettre bien en vue les tendances de développement et d'enrichissement du lexique en question par des mots de cette catégorie.

En dehors de l'éloignement de la forme du pluriel de l'acception du mot de base et sa transformation en un mot à part, au processus l'accroissement de nombre des qui ne sont usités qu'au seul pluriel en albanais concourt aussi la substantivation de l'adjectif, et notamment de celui d'origine verbale.

